# REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

| Nr. Rendor [1] | Data e kërkesës[2] | Objekti i kërkesës[3] | Data e përgjigjes[4] | Përgjigje[5] | Mënyra e përfundimit të kërkesës[6] | Tarifa[7] |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 13.01.2022 | Informacion lidhur me Shoqerine Koncensionare Porti MBM, qe operon ne Porto-Romano Durres | 24.01.2022 | Kthim pergjigje Z. Geri Emiri, gazetar ne median Amfora.al.<br>Kerkesa e juaj nuk eshte objekt i institucionit tone. | Email geriemiri@amfora.al | 0 |
| 2 | 22.02.2022 | Plotesim ankete studimore per master | 01.03.2022 | Jashte objektit te ligjit per te drejten e informimit | E-mail selashala@gmail.com | 0 |
| 3 | 11.04.2022 | Informacion mbi hyrjen e daljen e anijeve te peshkimit ne portin e Shengjinit dhe ne te gjitha portet shqipetare per periudhen 1.03.2021-10.04.2021 dhe 1.03.2022-10.04.2022 | 12.04.2022 | Për periudhën nga data 01.03.2021 deri me datën 10.04. 2021.<br>• Në portin e Shëngjinit kanë dalë për gjueti 141 anije peshkimi dhe kanë hyrë në port 121,<br>• Në të gjithë portet shqiptare kanë dalë për gjueti 2535 anije peshkimi dhe kanë hyrë në port 2430.<br>Për periudhën nga data 01.03.2022 deri me datën 10.04. 2022.<br>• Në portin e Shëngjinit kanë dalë për gjueti 72 anije peshkimi dhe kanë hyrë në port 70,<br>• Në të gjithë portet shqiptare kanë dalë për gjueti 1539 anije peshkimi dhe kanë hyrë në port 1541.<br><br>Shënim: Diferenca ndërmjet hyrjeve dhe daljeve tregon numrin e mjeteve që janë në det. | Gazetar Geri Emiri E-mail geriemiri@gmai.com | 0 |

[1] Numri rendor i kërkesave të regjistruara në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve
[2] Data e regjistrimit të kërkesës
[3] Përmbledhje e objektit të kërkesës duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi
[4] Data e kthimit të përgjigjes
[5] Përmbajtja e përgjigjes duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi
[6] Përgjigjia jepet E plotë/ E kufizuar/ E refuzuar/E deleguar
[7] Kosto monetare e riprodhimit (kur është rasti dhe e dërgimit) të informacionit të kërkuar sipas tarifave të publikuar nga autoriteti publik.

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 4 | 23.06.2022 | -Si paraqitet situata e peshkimit të paligjshëm në hapesirën detare shqiptare dhe cilat janë zonat më problematike ku ushtrohet peshkimi i paligjshem? Sa raste keni konstatuar gjatë këtij viti? Po në vitin e kaluar?<br>-Cilat janë format më të përhapura të peshkimit të ndaluar në ujrat tona dhe cilat zona?<br>-Peshkimi i gjallesave detare në periudhën e shumimit , po dhe i peshqve ( cironka, cikale etj.) është i ndaluar. A e monitoroni ju këtë dhe si? Sa raste keni konstatuar 3 vitet e fundit dhe cilat periudha?<br>-Sa funksional është bashkëpunimi juaj në këtë drejtim me ispektoriatin e Peshkimit dhe mjedisit për të reduktuar mbipeshkimin dhe peshkimin e ndaluar?<br>-Aktualisht ne sa anije peshkimi eshte instaluar sistemi i monitorimit blue-box dhe konkretisht cilave flotave ju përkasin? A shfaqet sërish fenomeni i shkëputjes/fikjes së blue-box që con në ndërprerjen e monitorimit satelitor?<br>-QNOD monitoron vetëm aktivitetin e anijeve të peshkimit të pajisura me | 28.06.2022 | -Monitorimi i hapësirës detare në Qendrën Ndërinstitucionale Operacionale Detare (QNOD), kryhet nga shërbimi 24 orësh i Sallës Operacionale në QNOD, duke shfrytëzuar të gjitha sistemet e vëzhgimit detar në dispozicion.<br>Shërbimi i peshkimit në sallën operacionale përgjigjet për monitorimin e situatës së peshkimit në hapësirën tonë detare. Duke filluar nga muaji Maj 2021, situata e peshkimit monitorohet nëpërmjet sistemit VMS (*Vessel Monitoring System*), që përfshin anijet e peshkimit mbi 12m.<br>-Si zona më problematike, mund të konsiderohen kryesisht grykëderdhjet e lumenjve, zonat e mbrojtura (Sazan, Karaburun), si dhe ujrat territoriale të vendeve fqinjë kryesisht (Mali i Zi dhe Greqi).<br>Nga rastet e dyshuara për peshkim të paligjsjshëm nga Salla Operacionale në QNOD, gjatë këtij viti, rezulton se nga Sektori i Inspektimit dhe Kontrollit të Peshkimit janë konstatuar 5 raste me shkelje të ligjit (masa administrative, vendim me gjobë, ku 3 mjete peshkimi, janë në Durrës). Ndërsa në vitin e kaluar (në periudhën Maj-Dhjetor) kur sistemi VMS ka qenë në funksion dhe në proces pilotimi, rezulton se nga Sektori i Inspektimit dhe Kontrollit të Peshkimit janë konstatuar 72 raste në shkelje të ligjit (masa administrative, vendim me gjobë, ku 30 mjete peshkimi janë në Durrës).<br>-Gjatë monitorimit të kryer, format më të përhapura kanë qenë rastet e mosrespektimit të distancës nga bregu, i anijeve të peshkimit. Shërbimi i peshkimit në Sallën Operacionale (QNOD), referuar sistemit VMS, i raporton Drejtorisë së Shërbimit të Peshkimit dhe Akuakulturës (DSHPA) të gjitha rastet kur dyshohet se mjetet e peshkimit ndodhen në distancën më pak se 3 milje, apo pranë zonave të mbrojtura. Për të verifikuar situatën në terren, koordinohet me përfaqësuesit e strukturave të tjera ligjzbatuese që kanë mjete lundruese në patrullim, apo që ndodhen më afër zonës, si dhe me inspektorët e peshkimit. | Gazetare Vali Qyrfyci e-mail valiqyrfyci @yahoo.co m | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | blue- box apo dhe anijet e tjera më të vogla dhe peshkatarët e bregut?<br>-Çdo raport, dokument dhe e dhënë në lidhje me peshkimin e ndaluar në vitet e fundit është i mirpritur. | | -Kjo pyetje i duhet adresuar DSHPA, si struktura përgjegjëse në MBZHR për politikat dhe teknikat e peshkimit.<br>Sherbimi i peshkimit në Sallën Operacionale të QNOD, monitoron situatën detare 24/7, për çdo dyshim të shkeljes së ligjit për peshkimin. Sa herë konstatohen raste, njoftohen menjëherë instancat përkatëse për verifikimin, kontrollin dhe marrjen e masave.<br><br>-Në Sallën Operacionale të QNOD, janë me shërbim 24/7 oficerë/ civilë të turnit për peshkimin, të cilët bashkëpunojnë me koordinatorët institucionalë për peshkimin dhe mjedisin, si dhe rast pas rasti me inspektorët e peshkimit dhe mjedisit.<br><br>-Sistemi *blue-box* ka qenë sistemi i mëparshëm i monitorimit të anijeve të peshkimit, por që nuk është më në funksion, aktualisht është në funksion sistemi i monitorimit të anijeve - VMS.<br>Nga të dhënat që dispozicion QNOD, rezulton se me VMS aktualisht janë pajisur 204 mjete peshkimi me gjatësi mbi 12 metra.<br>Në çdo rast, kur nga shërbimi i peshkimit në Sallën Operacionale në QNOD, konstatohet mosfunksionimi i pajisjes VMS në një anije të caktuar, informohen menjëherë strukturat përkatëse për marrjen e masave konkrete. Nuk është më një fenomen, rasti i shkëputjes/fikjes së sinjalit satelitor të VMS.<br><br>- QNOD, me anë të sistemeve në dispozicion të saj monitoron të gjitha mjetet lundruese në hapësirën tonë detare, por jo peshkatarët e bregut.<br><br>-Për informacione më të detajuar në lidhje me peshkimin e paligjshëm mund tu drejtoheni istancave përkatëse në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, si institucioni përgjegjës për inspektimin, kontrollin dhe marrjen e masave për peshkimin. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | 01.07.2022<br>-<br>30.09.2022 | Per periudhen Korrik-Shtator nuk kemi patur kerkesa. | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | 04.10.2022 | Informacion mbi hyrjet e daljet e çisternws "QUEEN MAJEDA", me aktivitet transportim hidrokarburesh ne Porto Romano. | 10.10.2022 | 1. Në cilat data ka mbërritur në portin "Porto Romano", Durrës anija cisternë "QUEEN MAJEDA", dhe në cilat data është larguar (për secilën herë)?<br><br>• Ka hyrë më 25.07.2022 dhe ka dalë më 26.07.2022.<br>• Ka hyrë më 23.08.2022 dhe ka dalë më 26.08.2022.<br>• Ka hyrë më 12.09.2022 (bllokuar në portin e Durrësit).<br><br>2. Cili është porti nisës i deklaruar nga është nisur anija (për secilën herë)?<br><br>• 07.2022 porti i deklaruar "Taranto" Itali.<br>• 08.2022 porti i deklaruar "Bengazi" Libi.<br>• 09.2022 porti i deklaruar "Bengazi" Libi.<br><br>3. Si është deklaruar ngarkesa që transportohej (për secilën herë)?<br><br>• 07.2022 ngarkesa e deklaruar "Marinë Gasoil".<br>• 08.2022 ngarkesa e deklaruar "Naftë"<br>• 09.2022 ngarkesa e deklaruar "Marinë Gasoil".<br><br>4. Për cilin subjekt tregtar pritës është deklaruar ngarkesa që transportohej (për secilën herë)?<br><br>• Nuk disponojmë të dhëna.<br><br>5. Na vendosni në dispozicion të dhëna të tjera që dispononi për rastet e udhëtimit të kësaj anije në Durrës. | Email, gazetar i BIRN | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | • Nuk disponojmë të dhëna të tjera, përvec atyre sa me lart, në lidhje me rastet e udhëtimit të kësaj anije në Durrës. | | |

[1] Numri rendor i kërkesave të regjistruara në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve
[1] Data e regjistrimit të kërkesës
[1] Përmbledhje e objektit të kërkesës duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi
[1] Data e kthimit të përgjigjes
[1] Përmbajtja e përgjigjes duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi
[1] Përgjigja jepet E plotë/ E kufizuar/ E refuzuar/E deleguar
[1] Kosto monetare e riprodhimit (kur është rasti dhe e dërgimit) të informacionit të kërkuar sipas tarifave të publikuar nga autoriteti publik.